

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njsela: Unit:	Nr. Prot.: Proc. No.:
Jednica: KEVP	271/18
Nr. i faqeve: No. of pages:	Data: Datum:
2	06.07.2018
Br. stranica:	Prihtinës



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 271/2018

KOMISIONI PËR EDUKIM TË VAZHDESHËM PROFESIONAL I OMK-SË, në mbështetje të Nenit 9, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.8, lidhur me Nenet 34 dhe 35, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 17, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.8 lidhur me Nenet 46 dhe 47, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.4 të Statutit të OMK-së, Nenin 5, paragrafin 2 me nën-paragrafët 2.1, 2.8 dhe 2.10 të Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, me datë 06.07.2018 nxjerrë këtë:

V E N D I M

për kriteret e formës dhe mënyrës së lëshimit të certifikatave për aktivitetet e EVP-së

- I. MIRATOHEN kriteret e formës së certifikatave të lëshuara për aktivitetet e akredituara të EVP-së, të cilat zbatohen nga subjektet e autorizuara sipas Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.
- II. Subjektet që kanë aplikuar për akreditim të aktiviteteve, planit vjetor dhe programeve, janë të obliguara që me rastin e lëshimit të certifikatave të aktiviteteve të akredituara të EVP-së tu përmbahen rregullave të përfshira në nën-paragrafët të këtij paragrafi:
 - II.I Certifikatat duhet të përmbajnë llogon zyrtare të Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK) e cila duhet të vendoset në këndin e epërm të djathtë të certifikatës.
 - II.II Certifikatat duhet të përmbajnë vendin e rezervuar për nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit për EVP, i cili duhet të jetë vendosur në këndin e poshtëm të djathtë të certifikatës.
 - II.III Certifikatat duhet të jenë të shtypura në formatin standard në dimensionin A4 (42.0 cm x 29.7 cm).
 - II.IV Certifikatat duhet të kenë të shënuar qartë emrin, mbiemrin e pjesëmarrësit në aktivitetin e EVP-së.
 - II.V Certifikata duhet të përmbajë në tekstin e saj emërtimin e plotë të aktivitetit siç është akredituar sipas certifikatës të lëshuar nga Komisioni i EVP-së.

II.VI Certifikata duhet të përfshijë numrin e pikëve të akredituara nga Komisioni për EVP, në përputhje me certifikatën e lëshuar nga Komisioni për EVP.

II.VII Subjekti zbatues i aktivitetit të akredituar është i obliguar që certifikatat t'i dorëzojë Komisionit për EVP së bashku me listën e nënshkruar të pjesëmarrësve të aktivitetit, vetëm pas përfundimit të aktivitetit të akredituar.

III. Subjektet që zbatojnë aktivitetin e akredituar janë të obliguara që t'i përmbahen kriterëve të përcaktuara me këtë vendim.

IV. Në rast të mosrespektimit të kriterëve të përcaktuara me këtë vendim, Komisioni për EVP do të ndërmerr masat e përcaktuara me Nenin 12, paragrafin 4 të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional ndaj zbatuesëve të aktivitetit të akredituar, me shqiptimin e ndalimit të akreditimit për periudhë deri në tri vite të ardhshme. Masa e tillë do të evidentohet në Regjistrin për EVP të cilin e mirëmbanë Komisioni për EVP.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 06.07.2018

Kryetari i Komisionit për EVP
Prof.ass. Dr. Shemsedin Sadiku

